

KËRKESË
Nr. 222/5, datë 28.2.2023

**PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR SHKËMBIMIN E PRONËS, PËR INTERES
PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësimin dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 345, datë 10.6.2021, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative Vorë, Bashkia Vorë, faza I”.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi, *kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim*, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasurinë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

2. Për pasuritë e llojit “njësi”, “ndërtesë banimi” dhe “apartament” është bërë sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në çmimet mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për miratimin e koston mesatare të ndërtimit, për vitin 2016.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Vorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi në shumën prej 5 469 533 (pesë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekësh.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE SHKËMBIMIT
Egra Ibrahim

[illegible]

1. Čimni sipas VKM nr.89, data 03.02.2016 - Per		Čimni (čik/m2)
Z. K.	3127	4242
2. Čimni sipas UKM nr.3, data 28.12.2019 per		Čimni (čik/m2)
1. Nijai Jānini: Apartament		32,113
2. Nijai abudžins*		32,113

*Per Nijiste e Sherkinshi, ehte xhifru amestizimi i objekte m moshetore te ligji nr. 843R, data 28.12.1998 (i predduruar, Neni 22, pika 3.

1. Čimni sipas VKM nr.89, data 03.02.2016 - Per		Čimni (čik/m2)
Z. K.	3127	4242
2. Čimni sipas UKM nr.3, data 28.12.2019 per		Čimni (čik/m2)
1. Nijai Jānini: Apartament		32,113
2. Nijai abudžins*		32,113

*Per Nijiste e Sherkinshi, ehte xhifru amestizimi i objekte m moshetore te ligji nr. 843R, data 28.12.1998 (i predduruar, Neni 22, pika 3.